

## **Hapet Thirrja për Bursa për stafin akademik në Programin Erasmus + për në Universitetin e Varnës, Bullgari.**

Në kuadër të programit Erasmus + është hapur thirrja për aplikime për bursa për mobilitete për stafin akademik të Universitetit të Tiranës në Universitetin e Varnës, Bullgari.

### **Llojet e mobilitetit përfshijnë:**

-Shkëmbimin e stafit akademik për mësimdhënie;

### **Kohëzgjatja e bursave:**

-Shkëmbimi i stafit akademik për mësimdhënie (5 ditë, duke përfshirë edhe ditët e udhëtimit);

### **Fushat e studimit:**

-Menaxhim;

-Financë.

### **Bursat përfshijnë:**

-Kompensimin ditor (140 EUR në ditë për stafin);

-Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës);

<b>DISTANCA E UDHËTIMIT</b> ( <a href="http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm">http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm</a> )	<b>Kompensimi</b>
Midis 100 dhe 499 KM	180 EUR
Midis 500 dhe 1999 KM	275 EUR
Midis 2000 dhe 2999 KM	360 EUR
Midis 3000 dhe 3999 KM	530 EUR
Midis 4000 dhe 7999 KM	820 EUR
8000 KM ose më shumë	1100 EUR

Për të përcaktuar distancën ju lutem referohuni në këtë link:

[http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance\\_en.htm](http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm)

## **Dokumentat e nevojshme për aplikim për stafin akademik:**

- CV+ lista e publikimeve (në gjuhën angleze);
- Kopje e Pasaportës;
- Një letër motivimi (në gjuhën angleze);
- Diploma e nivelit të fundit të studimeve;
- Certifikata e gjuhës së huaj në nivelin B2 të gjuhës angleze
- \*Plani i mobilitetit;
- Vërtetim punësimi;
- Vërtetim nga dekani i fakultetit tuaj që ju lejon të shkëputeni për të kryer mobilitetin nëse ju shpalleni fitues.

*\*Plani i Mobilitetit për stafin akademik është një dokument në të cilin duhet të specifikohet programi juaj i propozuar që do të kreyri gjatë periudhës së shkëmbimit. Ky dokument firmoset nga aplikanti dhe nga personi përgjegjës në Rektorat i cili është Koordinator i Institucional i Erasmus +, Z. Elton Skendaj.*

*KUJDES! Kur të sillni në rektorat planin e mobilitetit për t'u firmosur nga Z. Skendaj, duhet të bashkangjisni edhe dokumentin e vërtetimit nga dekani i fakultetit tuaj që ju lejon të shkëputeni gjatë kohës së mësimdhënies për të kryer mobilitetin.*

## **Për të shkarkuar formatin e Planit të Mobilitetit vizitoni:**

[http://www.unitir.edu.al/images/Bursat/Teaching\\_Mobility\\_Plan.pdf](http://www.unitir.edu.al/images/Bursat/Teaching_Mobility_Plan.pdf)

## **Afati për aplikime: 30 Nëntor 2016**

Dokumentacioni duhet dorëzuar dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Drejtoria e Komunikimit, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë si edhe të skanuara në adresën e emailit [iro@unitir.edu.al](mailto:iro@unitir.edu.al)

Për më shumë informacion mbi bursat mund të kontaktoni me Sektorin për Marrëdhëniet me Jashtë në adresën e e-mail: [iro@unitir.edu.al](mailto:iro@unitir.edu.al)

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikimin tuaj!

